



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Adresa: Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 9

Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al

Për: **BOE: - “LA - OR” sh.p.k.,** me NIPT K71420003R

Adresa: Autostrada Tiranë - Elbasan, Km. 6, “Palma Nova”
Berzhitë, Tiranë

- “SHANSI INVEST” sh.p.k., me NIPT J61924002T

Adresa: Farkë e Madhe, Sauk, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” - me mjete elektronike – Punë

Numri i referencës i procedurës: REF-62499-06-24-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe 110 kV Burrel - Bulqizë dhe rehabilitimi i Nënstacioneve 110 kV, Burrel dhe Bulqizë”

Kohëzgjatja e kontratës: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 29.06.2020, Nr. 39.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Fondi Limit: 656,980,980 (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 27.07.2020

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 2 (dy) ofertues, me vlerë përkatëse të ofruar:

- | | |
|-------------------------|--------------------|
| 1. BOE “LA - OR” shpk | me NIPT K71420003R |
| “SHANSI INVEST” sh.p.k. | me NIPT J61924002T |

me ofertë ekonomike 655,700,000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH.

2. OE “EVEREST” shpk me NIPT J78311921L

me ofertë ekonomike 656,700,980 (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “EVEREST” sh.p.k., me NIPT J78311921L, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse operatori ekonomik ofertues nuk ploteson vlerat e kërkuara lidhur me punët e ngjashme të paraqitura.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse i mungojnë kategoritë: Projektues gjeodet - Pika d dhe Studim gjeologo inxhinierik - hidrogeologjik - Pikat 9/b, d në licencën profesionale për fushën e projektimit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk disponon: Program të licencuar “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashëm si dhe të paktën 1 (një) Inxhinier Elektrik të certifikuar për përdorimin e programeve “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashme për realizimin e projektit të linjes.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse i mungon kategoria NS-20, shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë, klasifikimi A në licencën profesionale për fushën e zbatimit të punimeve.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka paraqitur vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk disponon në licencën e shoqërisë të paktën 1 (një) inxhinier elektrik, 1(një) inxhinier gjeolog si dhe stafin mbështetës të kërkuar në këtë kriter.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka në stafin e tij minimumi 1 (një) punonjes, të trainuar dhe të pajisur me certifikatë për përdorim Makineri shtrirje + terheqje dhe frenim përcjellesi (percj., tros, opgw).
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.10, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka në stafin e tij numurin e kërkuar për punonjës të certifikuar për punime në lartësi ku njeri prej tyre të jetë inxhinier.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.11, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka minimumin 2(dy) Inxhinierë elektrik të certifikuar për: arkitekturen dhe skemat e Nënstacioneve elektrike të TL; mbrojtje dhe komandime; Scada/RTU dhe rele.

- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.12, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk disponon numrin e kërkuar të mjeteve për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.14, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk është i pajisur apo kontraktuar ndonjë person fizik apo juridik që disponon licencë lëshuar nga QKB për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis me kod III.2.A, si dhe licencë lëshuar nga QKB për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me kod III.2.B (transportimi i mbetjeve të llojeve të ndryshme).
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.15, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka plotësuar kolonën me të dhënat teknike të ofertuar në të gjithë tabelat e paraqitura në specifikimet teknike të DT-ve.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.16, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse për listen e mallrave të kërkuara nuk ka paraqitur: 1. autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar 2. Katalog/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit si dhe 3. Dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “LA - OR” sh.p.k.**, me **NIPT K71420003R**, Adresa: Autostrada Tiranë - Elbasan, Km. 6, “Palma Nova” Berzhitë, Tiranë; & **“SHANSI INVEST” sh.p.k.**, me **NIPT J61924002T**, Adresa: Farkë e Madhe, Sauk, Tiranë; se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **655,700,000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë *Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km. 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.08.2020.

Ankesa: Jo.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova